

## SHTESAT PRINDËRORE PËR FËMIJËN E TRETË DHE NDRYSHIMET DEMOGRAFIKE



# HYRJE

---

Shtesat për fëmijën e tretë dhe të katërt u bënë temë diskutimi në vitin 2018 kur Ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska, deklaroi që modeli e dhënies së shtesave për fëmijë dhe prindër do të pësonte ndryshime, me arsyetimin që shtesat (të njohura si shtesa për fëmijën e tretë) që synonin rritjen e natalitetit, nuk kishin pasur ndikimin e duhur. Ky propozim u prit me shumë kritika, respektivisht nga partitë shqiptare, të cilat e interpretuan këtë ndryshim si akt të pamatur.

Në këtë hulumtim do të shqyrtojmë historikun e kësaj politike, rezultatet e mundëshme, si dhe do të shohim ndryshimet më të rëndësishme demografike që kanë ndodhur në vitet e fundit. Meqë të dhënat për numrin e shfytëzuesve të shtesave nuk janë publike, Instituti për Demokraci dhe Analiza Ekonomike (IDEA), me 09 tetor 2023 ka bërë kërkesë deri tek Ministria e Punës dhe Politikës Sociale duke i kërkuar këto informata me karakter publik. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale është përgjigjur brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shërbej si informues i debatit publik dhe të ngjallë debat mbi këtë temë, dhe jo domosdoshmërisht të bëjë evaluimin ekzakt të rezultatit të kësaj politike publike, meqë për evaluim më të thuktë duhet qasje në më shumë të dhëna të cilat bien përtej kornizës së këtij raporti.

## SHTESAT PRINDËRORE

---

Zhvillimi i veprimtarisë për mbrojtjen e fëmijëve përcaktohet me program vjetor të cilin në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve e realizon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është në funksion të krahasimit dhe përmirësimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve.

Në vitin 2008 Qeveria e udhëhequr nga VMRO-DPME dhe BDI miratoi Strategjinë për Zhvillimin Demografik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2008-2015, dhe në përputhje me të u bënë ndryshime përkatëse ligjore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve, dhe zbatimi i tyre filloi nga 1 janar 2009 (1). Ndër risitë e këtyre ndryshimeve ishin edhe shtesat për prindërit e fëmijëve dhe kishin për qëllim rritjen e natalitetit. Kjo iniciativë parashihte ndihmë financiare për nënat në komunat me shkallë nataliteti më të ulët se 2.1 fëmijë për grua. Iniciativa parashihte ndihmë financiare prej rreth 90 euro në muaj për fëmijën e dytë për nëntë muajt e parë, 120 euro në muaj



për një periudhë dhjetë vjeçare për fëmijën e tretë, dhe 190 euro në muaj për fëmijën e katërt për pesëmbëdhjetë vjet. Megjithatë, kjo iniciativë u hodh poshtë nga Gjykata Kushtetuese mbi bazën se ajo ishte diskriminuese meqë përjashtonte shumicën e komunave me shumicë shqiptare ku vetëm dy prej tyre përfshiheshin në këtë strategji të rritjes së natalitetit (2). Prandaj, si pasojë, të gjitha komunat u përfshinë në këtë iniciativë pamvarësisht shkallës së natalitetit dhe shtesat për fëmijë u bënë të qasshme për të gjitha nënat. Pra, këto shtesa jepeshin pamvarësisht të hyrave financiare të prindërve dhe si të tilla mbetën deri në vitin 2019 kur Ligji pësoi ndryshime gjatë qeverisjes LSDM-BDI

## **NDRYSHIMET E BËRA PËR SHITESËN PRINDËRORE NË VITIN 2019**

Me ardhjen në qeveri të LSDM-së me kryeministër Zoran Zaev, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve pësoi ndryshime të rëndësishme. Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, përkatësisht ish-ministrja Milla Carovska, propozoi ndryshime të ligjit me arsyetimin se politika e dhënies së shtesave deri në vitin 2018 nuk kishte pasur efekt në rritjen e natalitetit ashtu siç ishte synuar. Synimi ishte ndryshimi i paradigmës së dhënies së shtesave për prindërit, ku shtesat do të targetonin familjet me rast social dhe nuk do të ofroheshin për të gjithë prindërit.

Prandaj, ligji aktual i cili është ndryshuar në vitin 2019 parasheh shtesa të ndryshme për fëmijët dhe nënat, ndërsa këto shtesa janë të lidhura kryesisht me gjendjen sociale të familjeve. E rëndësishme për diskutimin tonë janë shtesat të cilat parashihen për nënat që lindin fëmijën e tretë.

Sipas nenit 38 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve të publikuar në Gz. Zyrtare nr. 104/19 të Republikës së Maqedonisë së Veriut, shtesa prindërore për fëmijë është një e drejtë e cila realizohet nga nëna për fëmijën e tretë të saj që ka lindur të gjallë. Realizimi i të drejtës për shtesa prindërore ka kushtet në vijim:

1. Nëna duhet të jetë shtetase e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendbanim të përhershëm për tre vitet e fundit para dorëzimit të kërkesës.
2. Të hyrat e përgjithshme mesatare të familjes së nënës në tre muajt e fundit para parashtrimit të kërkesës dhe gjatë shfrytëzimit të të drejtës duhet të jenë më të ulta se lartësia e rrogës minimale neto të përcaktuar për vitin paraprak.
3. Nëna duhet të kujdeset drejtpërdrejt për fëmijën dhe fëmijët e tjerë të saj nuk duhet të jenë të vendosur në institucione për mbrojtje sociale, familje kujdestare ose të jenë dhënë për adoptim.

Shuma e paraparë në ligj si shtesë për fëmijën e tretë është 8,048 denarë, shumë e cila përshtatet çdo vit mvarësisht nga rritja e standardit të jetesës.

1. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut (fq.250)

<https://www.slvesnik.com.mk/issues/5AB84E6DEF83584C847BD8AACF735678.pdf>

2. <https://balkaninsight.com/2009/04/02/macedonia-s-baby-boom-program-falls-in-court/>



## SHTESAT PRINDËRORE PËR FËMIJËN E TRETË: A KISHIN EFEKTIN E PRITUR?


Shtesat për nënat gjatë periudhës 2009–2018 kishin për qëllim stimulimin e natalitetit duke zvogëluar koston private të rritjes së fëmijëve përmes transfereve të parave për një periudhë të gjatë kohore. Politika e implementuar mori emrin “shtesat për fëmijën e tretë” meqë kryesisht beneficionet shkonin për nënat të cilat lindnin fëmijën e tretë, edhe pse ajo aplikohet edhe për fëmijën e katërt. Por sa ishte numri i shfrytëzuesve të kësaj politike?

Të dhënat për numrin e shfrytëzuesve të shtesës për fëmijën e tretë janë paraqitur në Figurën 1. Siç mund të shihet, numri i shfrytëzuesve të shtesës për fëmijën e tretë ka pasur ngritje të vazhdueshme nga viti 2013 deri në vitin 2019, edhe atë duke arritur maksimumin e 29,812 shfrytëzuesve në vitin 2019. Megjithatë, ky numër ka filluar të bie nga viti 2019, edhe atë me një rënie relativisht të shpejtë me mesatarisht 2,199 shfrytëzues më pak për çdo vit. Si pasojë, në vitin 2023 kemi vetëm 21,017 shfrytëzues, apo 8,795 më pak sesa në vitin 2019. Shkaqet e kësaj ulje janë ende të paqarta, mirëpo ndër shkaqet e mundëshme janë migrimi vdekjet, etj.

Është e rëndësishme të theksohet që edhe përkundër faktit që në vitin 2021 kemi pasur rritje të numrit të fëmijëve të tretë të lindur për 14.71%, përsëri kemi rënie të numrit të shfrytëzuesve të shtesës për fëmijën e tretë. Kjo mund të jetë pasojë e faktit që lindjet e fëmijës së tretë kanë ardhur nga familjet që nuk janë shfrytëzues të ndihmave sociale, migrimit të vazhdueshëm.

Figura 1

Numri total i shfrytëzuesve të shtesës për fëmijën e tretë, 2013-2023




Burimi: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale



Komunat me më së shumti shfrytëzues të shtesës për fëmijën e tretë në vitin 2023 janë komuna e Çairit dhe Tetovës me gjithësej 1,546 dhe 1,219 shfrytëzues respektiv (Figura 2). Analiza më e detajuar e të dhënave tregon që **45% e shfrytëzuesve të shtesës për fëmijën e tretë janë nga komunat me shumicë shqiptare**, ndërsa 55% nga komunat me shumicë jo-shqiptare.

Figura 2


Komunat me më së shumti shfrytëzues të shtesës për fëmijën e tretë, 2023



Burimi: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Figura 3

Përqindja e shfrytëzuesve të shtesës për fëmijën e tretë sipas shumicës së etnisë së komunave, 2023



Burimi: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale




## LINDJET E FËMIJËS SË TRETË

Numri i fëmijëve të tretë të lindur ka shënuar rritje që nga viti 2011 deri në vitin 2014 edhe atë mesatarisht me nga 166 fëmijë. Megjithatë, që nga viti 2014, pamvarësisht shtesave, numri i fëmijëve të tretë të lindur ka rënë mesatarisht me nga 98 fëmijë për çdo vit. **Rënia më drastike ka ndodhur në vitin 2020, edhe atë për 591 fëmijë apo 22.83% krahasuar me vitin paraprak, që është rënia më e madhe në dhjetëvjeçarin e fundit. Kjo korrespondon me ndryshimin e Ligjit ku shtesat për fëmijën e tretë.** Megjithatë, duhet pasur kujdes sepse korelacioni jo domosdoshmërisht nënkupton shkakësi. Në vitin 2021, pra gjatë kohës së pandemisë kem një rritje të fëmijëve të tretë të lindur për 14.71%, gjë e cila nuk ndodhi në shumë vende të botës meqë prindërit kishin ngurojë të bënin fëmijë nga paparishikueshmëria e së ardhmes.

Figura 4

Numri i fëmijëve të tretë të lindur, 2010-2023



Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

Figura 5

Shkalla e rritjes/zvogëlimit të lindjeve të fëmijës së tretë sipas vitit, 2011-2022





Figura 6 më poshtë paraqet komunat të cilat kanë pasur numrin më të lartë të fëmijëve të tretë të lindur për periudhën 2010–2022. 12 nga këto 15 komuna kanë pësuar rënie të numrit të lindjeve të fëmijës së tretë nga viti 2010 në vitin 2022, me mesatarisht 19 fëmijë më pak.

Figura 6

Komunat me numrin total më të lartë të lindjeve të fëmijës së tretë, 2010-2022




Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

Në anën tjetër, Figura 7 paraqet komunat të cilat kanë numër më të ulët të lindjeve totale të fëmijës së tretë. Duhet theksuar që 6 nga këto komuna nuk kanë pasur asnjë fëmijë të tretë të lindur në vitin 2022, e disa prej tyre me vite të tëra.

Figura 7

Komunat me numrin total më të ulët të lindjeve në periudhën 2010-2022, sipas komunave



Burimi: Enti Shtetëror për Statistika



# NUMRI TOTAL I SHFRYTËZUESVE TË SHITESËS PËR FËMIJËN E KATËRT

Numri i shfrytëzuesve të shtesave për fëmijën e katërt në vitin 2023 është 750 shfrytëzues, ndërsa ka shënuar rënie graduale nga viti 2014 mesatarisht nga 7 shfrytëzues. Në total, në vitin 2023 kemi 101 shfrytëzues më pak sesa në vitin 2014.

Figura 8

Numri i shfrytëzuesve të shtesës për fëmijën e katërt, 2013-2023





Figura 9 më poshtë paraqet 11 komunat me më së shumti shfrytëzues të shtesës për fëmijën e katërt. Përveç komunës së Butelit dhe Haraçinës, të cilat në vitin 2022 kanë pasur numër të barabartë me vitin 2014, të gjitha komunat e tjera kanë pësuar rënie të numrit të shfrytëzuesve mesatarisht me nga 8 shfrytëzues në krahasim me vitin 2014. Nga gjithësej 750 shfrytëzues të shtesës për fëmijën e katërt në vitin 2023, 35.20% janë nga komunat me shumicë të popullsisë shqiptare.

Figura 9

Komunat me më së shumti shfrytëzues të shtesës për fëmijën e katërt, 2022






Në anën tjetër, Figura 10, tregon 10 komunat me më së paku shfrytëzues të shtesës për fëmijën e katërt, të cilat kanë 0, 1 ose 2 shfrytëzues të total.

Figura 10

Komunat me më së paku shfrytëzues të shtesës për fëmijën e katërt, 2022




## KOSTOJA E SHTESAVE PËR FËMIJËN E TRETË DHE FËMIJËN E KATËRT

Në kulmin e numrit të shfrytëzuesve të shtesave për fëmijën e tretë dhe të katërt, buxhetit të shtetit këto shtesa i kushtonin 4,053,463 euro. Me ndërprerjen e këtij modeli të shtesave shpenzimet për këto lloj shtesash janë zvogëluar për çdo vit me mesatarisht nga 654,955 euro. Në vitin 2023 shpenzimet janë 29.50% më të ulta krahasuar me vitin 2019. Megjithatë, duhet të kihet parasysh që këto nuk janë shpenzimet e vetme për shtesa për fëmijë dhe prindër, meqë ndryshimet te fundit të modelit të shtesave parashohin një gamë të gjërë të shtesave për fëmijë dhe shpenzimet mund të jenë të larta.

Figura 11

Kostoja vjetore e shtesave për fëmijën e tretë (euro), 2013-2023



Burimi: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale




# SHKALLA TOTALE E FERTILITETIT (SHTF) NË MAQEDONINË E VERIUT

Shkalla natyrale e zëvendësimit, pra ajo e e cila siguron që popullsia të mbetet në nivel të njëjtë, është 2.1 fëmijë për çdo grua, ndërsa Shkalla Totale e Fertilitetit tregon numrin total të fëmijëve që një grua pritët të ketë gjatë jetës së saj në një shtet të caktuar. Në Maqedoninë e Veriut SHTF për pothuajse tre dekada është nën shkallën natyrore të zëvendësimit, ndërsa mesatarisht në 10 vitet e fundit ka qenë 1.45 fëmijë për çdo grua (Figura 12).

Çuditërisht, Maqedonia e Veriut ka pasur shkallë totale të fertilitetit edhe më të ulët sesa mesatarja e shteteve të OECD të cilat kanë standard të jetesës më të lartë sesa Maqedonia e Veriut, gjë që në shikim të parë duket kundërthënëse me atë që parasheh teoria në përgjithësi.

Figura 12

Shkalla e lindjes në Maqedoninë e Veriut, OECD dhe shkalla natyrore e zëvendësimit



Burimi: OECD


## NUMRI I FËMIJËVE TË LINDUR NDËR VITE

Numri total i lindjeve në maqedoninë e veriut ka shënuar rënie të vazhdueshme nga viti 2015 deri në vitin 2020, edhe atë mesatarisht për 3.77% për çdo vit. Megjithatë, edhe pse në shumë vende të botës nataliteti ra gjatë pandemisë (meqë nga kriza që kaploi botën prindërit nuk ishin të sigurtë për të ardhment e fëmijëve të tyre), për çudi në Maqedoninë e veriut numri i fëmijëve të lindur në vitin 2021 u rrit për 2,083 apo 12.57%, mirëpo në vitin 2022 kishim përsëri rënie të lindjeve prej 3.08% krahasuar me vitin 2021. Në analizën afatgjate, shohim që në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 kanë lindur 3,265 fëmijë më pak se në vitin 2010, apo kemi rënie prej 15.3% të numrit të fëmijëve të lindur.



Figura 13

Numri i fëmijëve të lindur në Maqedoninë e Veriut ndër vite




Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

Të gjitha etnitë kanë përjetuar rënie të numrit të lindjeve gjatë periudhës 2010-2022, përveç etnitetit vllah dhe atij boshnjak. Në anën tjetër, etnitë me rënie më të madhe të lindjeve janë romët me 45% dhe serbët me 35% rënie të lindjeve krahasuar me vitin 2010.

Figura 14

Rënia /rritja e numrit të fëmijëve të lindur sipas etnisë së babait, 2010-2022




Si pasojë e rënies më të madhe të numrit të lindjeve tek disa etni dhe rënies më të vogël tek disa etni tjera, ka ndryshuar poashtu edhe proporcioni i lindjeve të etnive nga totali i lindjeve. Siç mund të shihet në Figurën 15, përdërisa fëmijët e lindur me baba të etnitetit maqedonas përbënin 51.50% të lindjeve totale në vitin 2010, ato janë zvogëluar në 49.91% në vitin 2022. Në anën tjetër, përqindja e fëmijëve të lindur me baba shiptar është rritur për 4.96 pikë përqindje, pra nga 29.63% në vitin 2010, në 34.59% në vitin 2022. Në anën tjetër, përqindja e fëmijëve të lindur me baba të etnitetit rom është zvogëluar nga 5.38% në 3.96%.



Figura 15

Përqindja nga totali i lindjeve sipas etnisë së babait, 2010-2023




Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

## STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS MOSHËS

Lindjet gjithnjë e më të pakta dhe jetëgjatësia më e gjatë ka bërë që Maqedonia e Veriut të shohë ndryshim relativisht të konsiderueshëm të strukturës së popullsisë. Dukshëm kemi tkurrje të moshave më të reja dhe rritje të popullsisë në moshat më të shtyra (Figura 16).

Figura 16



Burimi: Enti Shtetëror për Statistika

Kostoja e këtyre ndryshimeve demografike bie mbi sistemin shëndetësor dhe pensional të cilat kanë gjithnjë e më shumë pacientë dhe penzioner për t'ua mbuluar shpenzimet, si dhe gjithnjë e më pak të rinjë të cilët kontribuojnë në këto sisteme me kontributet e tyre. Mirëpë kostoja më e lartë që mund të paguhet nga nataliteti gjithnjë e më i ulët është ndoshta mungesa e fuqisë puntore e cila veçmë ka filluar të ndihet në Maqedoninë e Veriut. Duke ja shtuar kësaj edhe migrimin permanent e mbi 12,000 personave për çdo vit nga Maqedonia e Veriut (3), atëherë problemi bëhet edhe më akut dhe kërkon zgjidhje më urgjente.

3. Westminster Foundation for Democracy: [https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-05/wfd-web-brochure-nm\\_final.pdf](https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-05/wfd-web-brochure-nm_final.pdf)



# PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

---

Të dhënat tregojnë që popullsia e Maqedonisë së Veriut ka pësuar ndryshime në dekadën e fundit, si nga struktura e moshës ashtu edhe për nga përbërja etnike. Si pasojë e natalitetit të ulët dhe migrimi të lartë, popullsia në Maqedoninë e Veriut po plaket dhe po tkurret, ndërsa proporcioni i etnive gradualisht po ndryshon si pasojë e shkallëve të ndryshme të natalitetit tek etnitë përkatëse.

Efektet ekzakte të politikës për rritje të natalitetit e cila ishte aktive deri në vitin 2019 është e vështirë të identifikohen me të dhënat ekzistuese. Ajo çfarë kemi parë deri tani është se numri aktiv i shfrytëzuesve të shtesave për fëmijën e tretë dhe të katërt ka pasur trend në rritje deri në vitin 2019, e pastaj një trend në rënie i cili përcillet deri në vitin 2023 si pasojë e ndryshimit të formës së shtesave. Ky trend megjithatë nuk korrespondon me numrin e fëmijëve të tretë dhe të katërt të lindur gjatë kësaj periudhe, numra të cilët qartazi kanë pësuar rënie, përveç viteve 2022 dhe 2023, të cilat mund të jenë të ndikuara nga efekti i pandemisë.

Pra duket që shtesat për fëmijën e tretë nuk e kanë ndaluar trendin rënës së lindjeve për fëmijën e tretë, megjithatë duhet pasur kujdes dhe mos të inferohet që shtesat për fëmijën e tretë nuk kanë pasur aspak efekt në motivimin e prindërve për të bërë fëmijë të tretë. Prandaj duhet të shihet me shumë kujdes efektin e mundshëm që këto shtesa mund ta kenë pasur në zbutjen e trendit rënës të lindjeve të fëmijës së tretë. Rënia drastike më e madhe në 9 vitet e fundit e lindjeve të fëmijës së tretë ka ndodhur pikërisht në vitin 2020 (rënie prej 22.83% krahasuar me vitin 2019), pra një vit pas ndërprerjes së shtesave prindërore për fëmijën e tretë në modelin gjithpërfshirës, duke sinjalizuar kështu efektin e mundshëm të shtesave në zbutjen e shkallës së rënies së lindjeve të fëmijës së tretë. Prandaj duhet pasur kujdes në konkluzat mbi efektin shtesave për fëmijën e tretë në modelin fillestar dhe natalitetit ndër vite, sepse parashtrohet pyetja logjike se sa vallë do të kishte rënë numri i fëmijëve të tretë të lindur poqëse këto shtesa nuk kishin ekzistuar. Fatkeqësisht, kjo pyetje nuk është parashtruar gjatë kohës kur u bënë ndryshimet e formës së shtesave.

Efekti i pandemisë vështirëson analizat mbi efektet potenciale të modelit aktual i cili është i orientuar drejt shtresave sociale, megjithatë modeli duket të jetë kundër-intuitiv meqë në përgjithësi nataliteti tek familjet me të hyra fiannciare më të ulta është gjithsesi në përgjithësi më i lartë sesa tek ata me të hyra më të larta. Prandaj vendoset pikëpyetja legjitime: a ishte qëllimi i ndryshimeve rritja e natalitetit, apo ishte lehtësimi i barrës financiare për rritjen e fëmijëve tek familjet me të ardhura të ulta? Kjo mbetet e paqartë duke e ditur që arsyeja kryesore e ndërprerjes së modelit paraprak u tha që ishte mungesa e efektit në rritjen e natalitetit.



Instituti IDEA rekomandon që të investohet në programe afatëgjata të cilat do të ndikonin në rritjen e natalitetit, edhe atë:

- Të kthehet mbështetja për të gjithë nënat të cilat linden fëmijën e tretë, meqë lidhja e shtesave për statusin ekonomik të familjeve, përveç që do të ketë paevitueshëm efekt negativ në stimulimin e familjeve që të jenë shfrytëzues të ndihmave sociale, nuk pritet të ketë efekt pozitiv në rritjen e natalitetit meqë targeton familjet me të ardhura të ulta të cilët gjasat janë të mëdha që gjithsesi do të kenë natalitet të lartë. Pra duhet të targetohen edhe nënat të cilat veçmë mund të jenë në mardhënie pune dhe kostoja financiare e fëmijëve për ta mund të jetë më e madhe.
- Të investohet në program për kursim të përbashkët, me çka për çdo denarë i kursyer për fëmijën nga ana e prindërve shteti do të jepte një denarë nga ana e tij. Këto kursime pastaj do të mund të përdoren vetëm për qëllime të caktuara në benefit të fëmijëve, siç janë shkollimi, shëndetësia, etj.
- Të investohet në më shumë balanc gjinor, meqë shembujt e shteteve skandinave tregojnë që barazia gjinore stimulon natalitetin. Këtu hyn edhe krijimi i infrastrukturës për rritje të fëmijëve, siç është krijimi i më vendeve në çerdhe dhe sa më afër vendeve të punës.



